

VENDIM
Nr.534, datë 4.8.2006

PËR PAJISJEN ME MJEDISE TË PARTISË REPUBLIKANE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 22 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim Partisë Republikane të mjediseve të katit të dytë, të ish-hotel “Drini”-t, në shtesën e re 5-katëshe, me sipërfaqe 323 m², në Rr.“Abdi Topani”, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si mjedise për seli.

2. Mjediset, që aktualisht janë në përdorim të Partisë Republikane, t’i kalojnë në përdorim Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Wopden 21 392 m2
 21 392 m2

